



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 04-104/02-4239/24
Kaçanik, 29.02.2024

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 29 shkurt 2024, pos tjerash,

NJOFTOHET


1. Me aktivitetin e zhvilluar të Drejtorisë së Arsimit, për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të Vitit shkollor 2023-2024, në bazë të dhënave të paraqitura në materialin e informatës, të hartuar nga Drejtoria e Arsimit.
2. Në Informatë është paraqitur gjendja e përgjithshme në fushën e arsimit në Komunën e Kaçanikut, veprimet të cilat janë marrë nga Drejtoria e Arsimit dhe mekanizmat tjerë relevantë për përmbushjen e objektivave të planeve të punës sipas legjislacionit që e rregullon këtë fushë, përfshirë edhe vështirësitë që e kanë përcjellë në përmbushjen e objektivave.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese, është materiali më tekstin e mëtejme, Informatë për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të Vitit shkollor 2023-2024 e përmbledhur në gjithsej: 18 faqe / Lënda: 04Nr. 104/02-4239/24.

Më këtë Shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Arsimit; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit
04 Nr 104/02-4239/24

I N F O R M A T Ë
Për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2023-2024

Kaçanik, Shkurt 2024

Përmbajtja:

1. Hyrje
2. Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor
3. Investimet në infrastrukturën shkollore e pajisje tjera dhe sigurimi i transportit të nxënësve
 - 3.1 Transporti i nxënësve
4. Ngritja e cilësisë – zbatimi i Kurrikulës së re
5. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimit parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)
 - 5.1. Rrjeti shkollor
 - 5.2. Sukseset e nxënësve – Arsimit fillor
6. Arsimit dhe Mesëm i Ulët (AMU, VI-IX)
 - 6.1. Numri i nxënësve dhe sukseset e tyre në dy nivelet 1 dhe 2
7. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve
8. Edukimi dhe Arsimit dhe Mesëm i Lartë (AML X – XII)
 - 8.1. Numri i nxënësve
 - 8.2. Sukseset e nxënësve
9. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve

Shkurtesat:

- DA Drejtoria e Arsimit
- MASHTI Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

- APF Arsimit Parafillor ose niveli 0
- AF Arsimit Fillor ose niveli 1 (klasa I-V)
- AMU Arsimit i Mesëm i Ulët ose niveli 2 (klasa VI-IX)
- AML Arsimit i Mesëm i Lartë ose niveli 3 (klasa X-XII)
- AJF Arsimit Joformal
- ShML Shkolla e Mesme e Lartë
- IAAP Institucioni i Aftësisimit dhe Arsimit Profesional
- ShFMU Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët
- QEAP Qendra për Edukimin dhe Arsimin Parafillor

1. Hyrje

Informata për përfundimin e Gjysmëvjektorit të Parë ka për qëllim të informoj publikun e gjërë dhe institucionet komunale mbi gjendjen e përgjithshme në fushën e arsimit në Komunën e Kaçanikut gjatë Gjysmëvjektorit të Parë, për vitin shkollor 2023-2024. Informata përmban punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit, respektivisht aktivitetet përgatitore për fillimin e vitit të ri shkollor, përgatitjet e objekteve shkollore, furnizimin e shkollave me materiale pedagogjike, furnizimin e nxënësve me tekste shkollore, regjistrimin e nxënësve në klasat e para dhe klasë të dhjeta, numrin e fëmijëve parafillor, fillor, të mesëm të ulët e mesëm të lartë dhe suksesin e arritur gjatë këtij gjysmëvjektorit mësimor.

Përmes këtij dokumenti, në formë tabelare janë prezentuar pasqyrat të cilat ofrojnë të dhëna për numrin e nxënësve sipas shkollave e sipas klasave, suksesi i arritur, kuadrin arsimor, mungesat e nxënësve e mësimdhënësve e të dhëna tjera të përgjithshme. Të dhënat e prezentuara janë bazë e mirë dhe mundësojnë analizimin e gjendjes së përgjithshme në sistemin e arsimit publik që zhvillohet në Komunën e Kaçanikut, në përputhje me Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, i cili zhvillohet në katër nivele: në nivelin 0, 1, 2, dhe 3 (Parafillor, Fillor, Mesëm të Ulët dhe Mesëm të Lartë).

Viti i ri shkollor 2023 - 2024 ka filluar me 1 shtator 2023 sipas kalendarit shkollor të hartuar nga MASHTI dhe ka përfunduar më 12 janar 2024, Mësimi filloi në të gjitha institucionet arsimore, përveç në Shkollë Fillore e të Mesme të Ulët "Naim Frashëri" në Kotlinë e cila që nga 1 shtatori i këtij viti (2023) e ka pushuar veprimtarisë edukative arsimorese për shkak të rënies së numrit të nxënësve dhe braktisjes së fshatit. Katër nxënësit e mbetur të kësaj shkolle kanë filluar të vijnë në klasat përkatëse në SHFMU "Idriz Seferi", Paralelja e ndarë fizike në Kovacec.

E po ashtu, edhe në objektin e SHFMU “Emin Duraku” në Dushkajë (Kaçanik), mësimi ka filluar me 5 ditë vonesë, ndërkohë që ditët e humbura do të plotësohen gjatë Gjysmëvjetorit të dytë.

2. Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor

Drejtoria e Arsimit, edhe sivjet ka filluar me kohë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/24, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e identifikuar për fillimin sa më të mbarë të procesit edukativo arsimor në Komunën tonë. Fillimisht është bërë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve para fillor e atyre në klasat e para. Bazuar në raportet e këtij fillim viti shkollor, sivjet janë regjistruar gjithsej 378 fëmijë para fillor, prej tyre 351 në shkollat fillore dhe 27 të tjerë në QEAP “Agimi” në Kaçanik, ndërkaq në këtë qendër parashkollore, nga moshë 9 muajshe deri në 5 vjeç, janë të sistemuar gjithsej 103 fëmijë. Po ashtu, në bazë të të dhënave të shkollave fillore, sivjet në klasën e parë janë regjistruar gjithsej 458 fatesë në kllat e para.

Po ashtu, është bërë edhe planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat e X-ta, në 2 shkollat e mesme: në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka”. Në Gjimnazin “Skënderbeu”, në klasat e dhjeta janë regjistruar 173 nxënës, ndërsa ishin planifikuar të regjistrohen 224 nxënës të ndarë në 7 paralele:

1. **Drejtimi Shkenca Natyrore**, 4 paralele me 92 nxënës të regjistruar
2. **Drejtimi Shkenca Shoqërore-Gjuhësore**, 3 paralele me 81 nxënës.

Ndërkaq, në IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” janë regjistruar gjithsej 159 nxënës në 10 paralele, ndërsa kanë qenë të planifikuar të regjistrohen gjithsej 288 nxënës të ndarë në 4 Drejtimet:

1. **Elektroteknikë me profilet:**
 - Teknik i Informatikës
 - Instalues Elektrikë dhe
 - Elektronikë industriale me nga 1 paralele,
2. **Ekonomi me profilet:**
 - Kontabilitet dhe tatime dhe
 - Tregti me shumicë dhe pakicë, me nga 1 paralele

3. Makineri me profilet:

- Instalues i ngrrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit e kanalizimit (2 paralele),
- Automekanik dhe
- Metalpunues, me nga 1 paralele dhe

4. Juridik me profilin:

- Nëpunës i administratës dhe shërbimeve të zyrës me një paralele

Sa i përket kuadrit arsimor, DKA gjithashtu me kohë e ka publikuar konkursin për plotësimin e vendeve të lira, ndërkohë që janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe selektimit për dy pozitat e lira, mësimdhënës të mësimit klasor dhe një psikologë në SHFMU “Idriz Seferi” në Bob me plotësim norme në QEAP “Agimi” në Kaçanik.

3. Investimet në infrastrukturën shkollore e pajisje tjera dhe sigurimi i transportit të nxënësve

Para fillimit të vitit të ri shkollor, në tri objekte shkollore janë bërë investimet kapitale në vlerë të përgjithshme prej afër 130 mijë euro, të planifikuara për renovim dhe riparime të nevojshme, ndërkaq në shkollën “Gafurr Luma” në Gllloboçicë është ndërtuar bazamenti i bustit të dëshmorit Gafurr Luma, emrin e të cilit me krenari e bartë shkolla në këtë fshat, për të cilin projekt është shpenzuar shuma prej mbi 4 mijë euro.

Në SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, në objektin e ri, në Dushkajë janë rregulluar/ndërtuar nyjat sanitare, ndërimi i disa dyerve të klasave e dyerve të nyjave sanitare, riparimi i dyshemesë në disa klasa, rregullimi i ndriçimit në hapësirat e jashtme, rregullimi i parkingut për vetura, lyerja e brendshme e objektit dhe asfaltimi i terrenit sportiv, ndërsa janë investuar afër 85 mijë euro, ndërkaq në ShFMU “Qamil Ilazi”, në objektin shkollor në Fushë Pajtimi është bërë renovimi i kulmit të objektit, izolimi dhe fasadimi i jashtëm, ndërimi i të gjitha dritareve dhe suvatimi e ngjyrosja e disa mureve të brendshme, për të cilat renovime është shpenzuar shuma prej 25 mijë euro. E ndërkaq, në objektin e shkollës në Kovaçec është bërë rregullimi i kulmit, për të cilin projekt janë investuar afër 15 mijë euro,

Këtë vit shkollor, qeveria e vendit nuk ka bërë furnizimin e nxënësve me libra, sikurse viteve të kaluara, ndërsa ka subvencionuar me nga 80 euro nxënësit e nivelit 1 – 5, dhe me nga 30 euro nxënësit e nivelit 6 – 9, por jo edhe ata të nivelit para fillor.

Furnizimi i nxënësve me libra ka qenë një nga sfidat e këtij fillim viti shkollor. Vlen të theksohet se ka pasur shumë raste kur prindërit për shkaqe të ndryshme nuk kanë arritur të aplikojnë në sistemin e Kosova, andaj edhe fëmijët e tyre kanë ngelur pa tekste shkollore.

3.1 Transporti i nxënësve

Edhe këtë vit shkollor 2023-2024 sikurse edhe vitin e kaluar, Drejtoria e Arsimit është duke i mbuluar/subvencionuar 100 % shpenzimet e transportit/bartjen për të gjithë nxënësit e Institucionit Arsimit dhe Aftësues Profesional (IAAP) “Ferzi Guri dhe vëllezërit Çaka”. Afër 12 mijë euro është shuma mujore e shpenzuar për mbulimin të gjithë nxënësve të shkollës profesionale, të cilët udhëtojnë nga vendbanimet e tyre e deri në shkollë dhe anasjelltas, dhe nxënësve të lokaliteteve të fshatit Glloboçicë, Kotlinë, Ivajë dhe Gajre të cilët vijojnë mësimet në Gjinnazin “Skënderbeu” në Kaçanik dhe nxënësve të disa shkollave fillore cilët udhëtojnë nga fshati Llanishte në shkollën “Emin Duraku” në Kaçanik, nxënësit e fshatit Semajë në shkollën e Elezajve dhe atyre të Sllatinë e Fushë Pajtimi në shkollën e Doganajve. Ndërkaq, është 700 euro shuma mujore që shpenzohet për mbulimin e udhëtimit të nxënësve/fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët udhëtojnë në relacionin Ferizaj – Prizren (Qendrën burimore) dhe anasjelltas.

4. Ngritja e cilësisë - Zbatimi i Kurrikulës së re

DKA, mbështet dhe përkrahë përkujdesjen për ngritjen e cilësisë në procesin mësimor, duke implementuar reformat në mësimdhënie dhe nxënie dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit tanë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre në vend e më gjërë. Po ashtu, DKA vazhdimisht identifikon nevojat e mësimdhënësve për trajnime, respektivisht zhvillimin profesional, ku synohet aplikimi i shkathësive të reja, por edhe zhvillimit e ngritjes profesionale, ndërkaq zbatimi i Kurrikulës së re bërthamë dhe ngritja e sistemit efikas ofron mundësi për sigurimin e cilësisë dhe përgatitjen e nxënësve për sfidat e jetës.

Me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim, rritjes/shtimit të nivelit të përgjegjësisë dhe angazhimit edhe më të madh në shkollë, gjatë këtij gjysmëvjetori, DKA ka realizuar vizita pune në 11 institucione arsmore (shkolla) nga 14 sa janë gjithsej. Vizita pune janë realizuar në SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik me paralelet e ndara në Dushkajë dhe Runjëvë, “Jusuf Gërvalla” në Biçec dhe Paralelen e ndarë në Nikaj, “Kadri Zeka” në Dubravë dhe Paralelet e ndara në Vatë e Provoli, “Ali Asllani” në Doganaj, “Nazmi Osmani” në Elezaj dhe Paralen e ndarë në Bajnicë, “Qamil Ilazi” në Kaçanik të Vjetër dhe Paralelen e ndarë në Fushë të Pajtimin, “7 Shtatori” në Begracë, “Gafurr Luma” në Glloboçicë, “Dituria” në Ivajë dhe Paralelen e ndarë në Strazhë, “Agim Bajrami” në Stagovë dhe në SHML Gjinnazi “Skënderbeu” në Kaçanik. Në tri institucionet e mbetura, vizita pune do të realizohen gjatë gjysmëvjetorit të dytë.

Gjatë vizitave janë përfshi inspektime/monitorime të ndryshme duke përfshirë përcjelljen e ambientit të jashtëm e brendshëm shkollor, niveli i pastërtisë, rendi shtëpiak, vijimi i rregullt i nxënësve dhe mësimdhënësve, kontrollimi i dokumentacionit pedagogjik, vlerësimi i nxënësve, mirëmbajtja e ditarëve të punës, funksionimi i aktiveve profesionale, zhvillimin e aktiviteteve të lira, funksionimin e Këshillave Drejtues të Shkollave dhe funksionimin e trupave tjerë në shkollë, mjetet mësimore në dispozicion e kabinetet dhe furnizimi i tyre me mjete e pajisje shkollore etj.

Ndryshe, gjatë pjesës së fundit të këtij gjysmëvjetori, përgjatë një jave rresht (11 – 15 dhjetor 2023), në SHFMU “Idriz Seferi” në Bob dhe dy Paralelet e ndara; në Gajre e Kovaçec është bërë vlerësimi i jashtëm i shkollës, respektivisht është realizuar Projekti “Përkrahja për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë”, udhëhequr nga eksperti i fushës së arsimit, z. Robert Blease, nga organizata KosEd, ndërsa financohet nga Bashkimi Evropian. Vlerësimi është bërë nga Ekipi Komunal për vlerësim i përbërë nga zyrtarë komunal të arsimit, drejtorë shkollash, koordinatorë të cilësisë, mësimdhënës lëndor e klasor, ndërsa qëllim kishte përmirësimin e praktikave pedagogjike në klasë, përkatësisht identifikimin e praktikave jo të mira dhe dhënien e këshillva për përmirësimin e tyre. Vlerësimi është bërë edhe duke u bazuar në kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës së shkollës, respektivisht 5 fushave të cilësisë: 1 Menaxhimi dhe qeverisja, 2. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve, 3. Mësimdhënia dhe nxënia, 4. Kultura dhe mjedisi dhe 5. Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve. Vlerësimi i jashtëm i shkollës ka përmblajtur edhe kriteret tjera: Organizimin dhe funksionimin e organeve të shkollës, Monitorimi i orëve mësimore dhe vlerësimi i performancës në arsim, Bashkëpunimi dhe klima pozitive në shkollë, Bashkëpunimi me prindër dhe përfshirja e tyre në organet vendimmarrëse etj

5. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimimi parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)

Duke u bazuar në plan-programin për arsim parafillor dhe fillor, planin dinamik të punës, obligimet dhe përgjegjësitë e sektorit të arsimit në organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në Komunën e Kaçanikut, janë bërë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim me shkollat dhe komunitetin për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor dhe eliminimin e dobësisve me qëllim të ngritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe nxënie. Edhe gjatë këtij gjysmëvjetori, rëndësi e veçant i është kushtuar zhvillimit dhe thellimit të dijes, kultivimit të identitetit personal, zhvillimit të përgjegjësisë, aftësisë për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që fëmijët të krijojnë kushte për zhvillim të pavarur personal dhe ndërtimit të mirëqenies së tyre në përgjithësi.

Arsimit parashkollor (nivelet 0) për fëmijët e moshës pesë vjeç, edhe deri më sot, është trajtuar në mënyrë meritore duke iu kushtuar vëmendje e veçant. Në të gjitha shkollat fillore e të mesme të ulëta funksionojnë klasat parafillore, përveç në 3 paralelet e ndara fizike, në fshatin Strazhë, Vatë e Provoli.

Në nivelin 0 (parafillor) sivjet janë regjistruar gjithsej 378 fëmijë prej tyre 351 në shkollat fillore e të mesme të ulëta dhe 27 fëmijë të tjerë të përfshirë në QEAP "Agimi.

Arsimi bazë përfshinë nivelet 1 dhe 2 apo arsimin fillor (1-5) dhe arsimin e mesëm të ulët (6-9). Arsimi fillor e i mesëm i ulët ofron mundësi dhe synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave dhe sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë.

Arsimi i mesëm i lartë (niveli 3), në Komunë e Kaçanikut zhvillohet në 2 shkollat e mesme të larta; në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe IAAP "Feriz Guri e vëllezërit Çaka". Përmes këtij niveli, synohet zhvillimi i mëtejshëm i kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi, thellimi i dijeve në fusha të caktuara, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës. Politikat tona zhvillimore janë të orientuara në përfshirjen apo krijimin e mundësisë për çdo nxënësi që përfundon arsimin bazë të regjistrohët në arsimin e mesëm të lartë. Po ashtu, fokus është përfshirja e numrit sa më të madh të nxënësve në drejtimet që ofron Shkolla Profesionale "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" e po ashtu, edhe në Gjimnazin "Skënderbeu".

5.1 Rrjeti shkollor

Në Komunën e Kaçanikut funksionojnë 11 shkolla amë, fillore e të mesme të ulëta dhe 10 paralele të ndara fizike:

1. SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik me paralelet e ndara në Dushkajë dhe Runjevë
2. SHFMU "Idriz Seferi" në Bob me paralelet e ndara në Kovaçec e Gajre
3. SHFMU "Jusuf Gërvalla" në Biçec me paralelet e ndarë në Nikaj
4. SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravë me paralelet e ndara në Vatë e Provoli
5. SHFMU "Ali Asllani" në Dogana
6. SHFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj me paralelet e ndarë në Bajnicë
7. SHFMU "Qamil Ilazi" me paralelet e ndarë në Fushë të Pajtimit
8. SHFMU "7 Shtatori" në Begracë
9. SHFMU "Agim Bajrami në Stagovë
10. SHFMU "Gafurr Luma" në Gilloboçicë dhe
11. SHFMU "Dituria" në Ivajë me paralelet e ndarë në Strazhë

Përveç shkollave fillore e të mesme të ulëta, në Komunën e Kaçanikut funksionojnë edhe 2 shkolla të mesme: Gjinnazi “Skënderbeu” dhe IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” në Kaçanik dhe një qerdhe për fëmijë, QEAP “Agimi” në Kaçanik. Bazuar në gjendjen fizike të objekteve shkollore, mundë të konstatojmë se rrjeti i shkollave të nivelit AF, AMU dhe AML është i kënaqshëm dhe ekzistojnë kushte relativisht të mira për zhvillimin normal të procesit mësimor, me përjashtim të objekteve të vjetër të Shkollës fillore “Emin Duraku” në Kaçanik dhe shkollës më Doganaj. Të dy këto objekte shkollore janë shumë të vjetëruara dhe të dëmtuara, ndërkohë që nuk plotësojnë kushtet minimale për zhvillimin e procesit mësimor. Ndërtimi i objekteve të ri shkollor në Doganaj, i filluar në vitin 2019, sipas kontratës është dashtë të përfundoj më 2022 dhe tani më ka kaluar afatet kohore të planifikuara, ndërkohë DKA, është duke bërë përpjekje të pareshtura për të siguruar investimet e nevojshme për ndërtimin e objekteve të ri shkollor në shkollën e qytetit, përkatësisht objektet të SHFMMU “Emin Duraku” në Kaçanik.

5.2 Sukseset e nxënësve, Arsimit Fillor (1 – 5)

Në nivelin fillor, nga gjithsej 2228 nxënës sa ishin të regjistruar në fillim të këtij Gjysmëvjetori, kanë vijuar gjithsej 2190 prej tyre, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 2171 nxënës, apo shprehur në përqindje 99.13 %. Me sukses negativ kanë ngelur 19 nxënës e 38 të tjerë nuk kanë vijuar ose janë çregjistruar.

Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor, gjithsej 2228 me 2280 sa ishin regjistruar një vit më parë (2022/23), atëherë del se në këtë vit shkollor, në këtë nivel, janë regjistruar gjithsej 52 nxënës më pak, ndërsa nota mesatare e këtij niveli arsimor është 3.87.

Për më shumë të dhëna në nivelin I-V, shih Tabelën Nr. 1

Sukseset në Arsimin Fillor (I - V) në Gjysmëvjetori i Parë të vitit shkollor 2023 – 2024

Klasa	SUKSESI POZITIV						SUKSESI NEGATIV						TE PANOTUAR						Nota mesatare										
	Gj.nxenes		Viojinë		Shkelq.		Sh.mire		Mire		Miaft.		Gj.pozitiv		%		Me 1x1			Me 2x1		Me 3x1		Gj.negativ		Nuk vijoin		Te cregjis	
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F
I	455	227	445	220	278	146	87	44	63	25	12	2	440	217	98.54	2	0	0	0	0	3	3	5	3	4	4	6	3	3.69
II	459	223	453	221	270	152	96	41	54	21	28	7	449	221	98.72	1	0	1	0	2	0	4	0	1	0	5	2	4.10	
III	432	190	422	189	217	113	100	38	77	26	26	11	420	188	99.81	1	0	0	0	1	1	2	1	0	0	10	1	3.64	
IV	438	218	429	215	193	179	121	57	79	28	32	10	425	215	99.27	0	0	1	0	3	0	4	0	0	0	9	3	3.9	
V	444	202	441	201	206	119	109	42	88	31	34	5	437	200	99.18	1	0	1	1	2	0	4	1	0	0	3	1	4.04	
I-V	2228	1060	2190	1046	1164	626	513	222	361	131	132	36	2171	1041	99.13	5	0	3	1	11	4	19	5	5	4	33	10	3.87	

6. Arsimi i Mesëm i Ulët (VI-IX)

Numri i nxënësve në AMU në fillim të vitit shkollor 2023-2024 ishte 1794, prej tyre 858 femra, ndërsa nëse e krahasojmë me një vit më parë (gjatë vitit shkollor 2022-2023 (ky numri i nxënësve ishte 1847), del se në këtë vit shkollor, në nivelin e mesëm të ulët, janë gjithsej 53 nxënës më pak.

Nga numri i përgjithshëm prej 1794 nxënësve të nivelit AMU, kanë vijuar 1767 dhe janë vlerësuar me nota pozitive gjithsej 1292 nxënës apo shprehur në përqindje 73.11 %, ndërkrah me nota negative kanë ngelur gjithsej 475 e 27 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e këtij niveli arsimor del të jetë 3.49.

Për më shumë të dhëna për nivelin VI-IX, shih Tabelën Nr. 2

Suksesi në Arsimin e Mesëm të Ulët (VI - IX) në Gjysmëvjetorin e Parë të vitit shkollor 2023 – 2024

Klasa	SUKSESI POZITIV												SUKSESI NEGATIV						TE PANOTUAR			Nota mesatare																					
	Gj.nxenes			Vijojnë			Shkelq.			Sh.mire			Mre			Mfast.			Gj.pozitiv				%			Me 1x1			Me 2x1			Me 3x1			Gj.negativ			Nuk vijojn			Te çregjis		
	GJ	F		GJ	F		GJ	F		GJ	F		GJ	F		GJ	F		GJ	F			GJ	F		GJ	F		GJ	F		GJ	F		GJ	F		GJ	F		GJ	F	
VI	454	214	444	209	157	107	129	68	13	65	13	10	363	194	89.06	29	10	21	2	27	3	81	15	2	1	8	4	3.72															
VII	445	223	440	219	130	97	90	57	85	38	15	2	320	196	67.36	33	9	15	3	72	11	120	23	0	0	5	3	3.41															
VIII	464	219	458	218	119	82	93	66	94	34	11	2	321	184	76.72	50	20	29	9	58	5	137	34	1	0	5	1	3.54															
IX	431	202	425	197	108	75	91	50	65	33	24	5	288	142	68.27	39	16	30	6	68	12	137	34	0	0	6	5	3.31															
VI-IX	1794	858	1767	842	514	361	403	242	309	118	63	19	1292	737	73.11	151	54	95	21	229	31	475	106	3	1	24	13	3.49															

6.1 Numri i nxënësve dhe suksesi i tyre në të dy nivelet 1 dhe 2 (I-V dhe VI –IX)

Numri i përgjithshëm i nxënësve në këto dy nivele, të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2023-2024 ka qenë 4022 (1918 femra) prej të cilëve kanë vijuar gjithsej 3957, ndërsa me sukses pozitiv janë vlerësuar 3463 apo 87.51 %. Ndërkaq, me nota negative kanë mbetur 494 nxënës prej tyre 111 femra e 65 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e përgjithshme e dy niveleve është 3.77. Nëse e krahasojmë këtë numër të nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2023-2024 (4022) me numrin e nxënësve të regjistruar një vit më parë (4177) del se gjatë këtij viti shkollor numri i nxënësve të regjistruar është më i vogël për 105 nxënës.

Për më shumë të dhëna për nivelin I-IX, shih Tabelën Nr. 3
 Suksesi sipas klasave I – IX në nivelin fillor dhe mesëm të ulët

Gj. nxenes	SUKSESI POZITIV												SUKSESI NEGATIV						TE PANOTUAR						Nota mesatare			
	Viojnë		Shkelq.		Sh.mire		Mire		Miaft.		Gj.pozitiv		%		Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj.negativ		Nuk vijnë			Te çregjis		
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ
I	455	227	220	278	146	87	44	63	25	12	2	440	217	98.54	2	0	0	0	3	3	5	3	4	4	4	6	3	3.69
II	459	223	221	270	152	96	41	54	21	28	7	449	221	98.72	1	0	1	0	2	0	4	0	1	0	5	2	4.10	
III	432	190	422	217	113	100	38	77	26	26	11	420	188	99.81	1	0	0	0	1	1	2	1	0	0	10	1	3.64	
IV	438	218	429	215	193	179	121	57	79	28	32	10	425	215	99.27	0	0	1	0	3	0	4	0	0	0	9	3	3.9
V	444	202	441	201	206	119	109	42	88	31	34	5	437	200	99.18	1	0	1	1	2	0	4	1	0	0	3	1	4.04
I-V	2228	1060	2190	1046	1164	626	513	222	361	131	132	36	2171	1041	99.13	5	0	3	1	11	4	19	5	5	4	33	10	3.87
VI	454	214	444	209	157	107	129	68	65	13	13	10	363	194	89.06	29	10	21	2	27	3	81	15	2	1	8	4	3.72
VII	445	223	440	219	130	97	90	57	85	38	15	2	320	196	67.36	33	9	15	3	72	11	120	23	0	0	5	3	3.41
VIII	464	219	458	218	119	82	93	66	94	34	11	2	321	184	76.72	50	20	29	9	58	5	137	34	1	0	5	1	3.54
IX	431	202	425	197	108	75	91	50	65	33	24	5	288	142	68.27	39	16	30	6	68	12	137	34	0	0	6	5	3.31
VI-IX	1794	858	1767	842	514	361	403	242	309	118	63	19	1292	737	73.11	151	54	95	21	229	31	475	106	3	1	24	13	3.49
I-IX	4022	1918	3957	1889	1680	987	916	464	670	249	195	55	3463	1778	87.51	156	54	98	22	240	36	494	111	8	5	57	23	3.77

Suksesi i nxënësve sipas shkollave prezantohet përmes Tabelës Nr. 4

Nr. shk. oll.	Gjithsej nxënës		Vijojnë		SUKSESI POZITIV										%	SUKSESI NEGATIV						Të Panotuar			Nota mesatare			
	Gj	F	Gj	F	Shkëlq		Shumë mirë		Mirë		Mjaft.		Gjithsej pozitiv			1x1		2x1		3x1		Gj negativ		Nuk vijojnë		Cregjistru ar		
					Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F		Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj		F	Gj	F
1 "ED"	1318	632	1308	628	582	351	312	162	187	65	59	11	1140	589	87	44	18	29	4	95	17	168	39	3	2	7	2	3.89
2 "KZ"	395	188	366	174	136	82	82	47	66	24	16	7	300	160	82	18	9	7	1	41	4	66	14	1	1	28	13	3.59
3 "I.S"	452	224	452	224	200	87	107	59	99	41	32	7	438	221	97	7	2	6	1	1	0	14	3	0	0	0	0	3.95
4 "J.G"	288	144	284	142	138	87	73	34	43	14	9	2	263	137	91	6	2	5	3	10	1	21	5	4	2	0	0	3.97
5 "N.O."	296	139	296	139	134	79	54	23	59	27	17	5	264	134	100	19	4	9	1	4	0	32	5	0	0	0	0	3.82
6 "Q.I."	407	185	406	185	159	102	98	47	59	14	9	1	325	164	80	18	6	17	7	46	8	81	21	0	0	1	0	3.79
7 "A.A"	273	128	273	128	111	67	69	33	50	22	11	2	241	124	88	12	2	10	2	10	0	32	4	0	0	0	0	3.78
8 "7.Sh	254	120	248	120	109	67	40	16	29	14	14	6	195	103	79	20	10	8	2	25	5	53	17	0	0	6	0	3.79
9 "G.L."	119	57	115	55	45	25	27	17	23	9	9	2	104	53	90.43%	5	1	6	1	0	0	11	2	0	0	4	2	3.85
10 "A.B."	157	67	155	66	51	31	39	14	41	17	8	3	139	65	90	7	0	1	0	8	1	16	1	0	0	2	0	3.62
11 "Ditu"	63	34	54	28	15	9	15	12	14	2	11	9	54	28	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	9	6	3.42
Gjith	4022	1918	3957	1889	1680	987	916	464	670	249	195	55	3463	1778	88	156	54	98	22	240	36	494	111	8	5	57	23	3.77

7. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve

Për t'u arritur sukses i dëshiruar, komponentë e rëndësishme është vijueshmëria e rregullt e mësimdhënësve dhe nxënësve në mësim. Ndryshe, mosvijimi i rregullt në orët e mësimit ndikon negativisht në suksesin e nxënësve, ndërkohë që ky tregues merret edhe si pasqyrë e mosdisiplinës së duhur në shkollë.

Në dy nivelet arsimore (I – IX), në këtë Gjysmëvjetor janë angazhuar gjithsej 343 mësimdhënës (171 mashkuj e 172 femra) prej tyre 131 në mësimin klasor dhe 212 në atë lëndor, ndërsa të kualifikuar rezultojnë të jenë 342 apo shprehur në përqindje 99.5 %. Nxënësit e këtyre dy niveleve, AF dhe AMU, përgjatë këtij gjysmëvjetori, kanë bërë gjithsej 64,098 mungesa prej tyre 48,253 të arsyeshme, ose 15.93 orë për kokë nxënësi. Ndërkaq, mësimdhënësit gjatë kësaj periudhe kanë humbur 957 orë mësimore ose mesatarisht nga 2.79 orë.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr. 5

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe mesme të ulëta

Nr.	Emri i shkolles	KUADRI ARSIMOR																	Mesat. për nx.	Orët e mbajta për arsimt	Mesat për arsimt
		Mësimi klasor			Mësimi lëndor			Dy ciklet				Mungesat e nxënësve									
		Mësimi klasor		%	Mësimi lëndor		%	F	Kv	GJ	F	Kv	%	GJ	ARS.						
		Gj	F		Kv	%										Gj	F	Kv			
1	"Emin Duraku"	35	35	100	46	20	46	100	81	55	81	100	23563	18778	17.88	209	2.58				
2	"Kadri Zeka"	16	6	100	16	6	16	100	32	12	32	100	7763	5381	19.6	104	3.25				
3	"Idriz Seferi"	15	9	100	21	9	21	100	36	18	36	100	5454	3668	12	81	2.25				
4	"Jusuf Gërva lla"	12	9	100	17	8	17	100	29	17	29	100	5335	4689	18.52	120	4.13				
5	"Qamil Ilazi"	15	10	100	21	6	21	100	36	16	36	100	6614	5410	10.39	42	1.16				
6	"Nazmi Osmani"	10	9	100	16	7	16	100	26	16	26	100	3387	3113	11.44	65	2.5				
7	"Ali Asllani"	7	4	100	19	9	19	100	26	13	26	100	3879	3491	14.2	34	1.3				
8	"7 Shtatori"	6	3	100	15	9	15	100	21	12	21	100	3579	83	14.09	51	2.42				
9	"G.Luma"	5	1	100	11	3	11	100	16	4	16	100	1564	1406	13.6	19	1.18				
10	"A.B."	5	3	100	13	3	13	100	18	6	18	100	2551	1902	16.45	76	4.22				
11	"Dituria"	5	0	80	17	3	17	100	22	3	21	95	409	292	7.3	156	7.09				
	Gjithsej	131	89	130	98.2	212	83	212	100	343	172	342	99.5	64098	48213	15.93	957	2.79			

8. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (X - XII)

Në arsimin e mesëm të lartë, synim kryesor është zhvillimi, zgjerimi dhe thellimi i dijeve dhe njohësisht edhe kultivimi i identitetit personal, zhvillimi i përgjegjësisë, aftësisht për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që nxënësit të përballojnë sfidat e jetës dhe të punës dhe integritetit më të lehtë të tyre në shoqëri.

Edukimit dhe arsimimit në nivelin e Arsimit të Mesëm të Lartë (AML), po ashtu, i është kushtuar rëndësi e veçantë pasi në këtë nivel merren hapat për të vazhduar studimet superiore, e po ashtu, edhe për përgatitjen profesionale të gjeneratave për tregun e punës.

8.1 Numri i nxënësve

Në vitin shkollor 2023-2024 në dy shkollat e mesme janë regjistruan gjithsej 965 (520 mashkuj dhe 445 femra) prej tyre 560 në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 405 në IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të regjistruar këtë vit shkollor, gjithsej 965 nxënës, me atë të vitit të kaluar prej 973 nxënës, atëherë del se sivjet në të dy shkollat e mesme janë regjistruar 8 nxënës më pak. Në kuadër të Gjimnazit "Skënderbeu" janë duke funksionuar 2 drejtime me po aq profile: Shkenca Natyrore me gjithsej 12 paralele (nga 4 paralele në klasat X, XI dhe XII) dhe Shkenca Shoqërore-Gjuhësore, po ashtu me 12 paralele dhe atë 3 në klasën e X, 4 në të XI dhe 5 paralele në të XII.

Ndërkaq, në IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" procesi mësimor është duke u zhvilluar në 30 paralele dhe atë 10 paralele në klasat e dhjeta me 4 drejtime: 1 Elektronikë, 2. Ekonomi, 3. Makineri dhe 4. Juridik, 10 paralele në klasat e njëmbëdhjeta me 3 Drejtime: 1. Elektronikë, Ekonomi dhe 3 Makineri e po ashtu, edhe 10 paralele në klasat e 12 me 4 Drejtimet: 1. Elektronikë, 2. Ekonomi, Makineri dhe 4. Juridik.

8.2 Sukseset e nxënësve

Nga numri i përgjithshëm prej 965 nxënës (445 femra) të regjistruar në fillim të vitit, mësimin e kanë vijuar gjithsej 922 nxënës, prej tyre 436 femra, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 518 ose 56 %.

Me nota të pamjaftueshme kanë mbetur 404 nxënës ose 43.81 % prej tyre dhe të përdoruar e të çregjistruar kanë mbetur gjithsej 43.

Suksesi i arritur reflekton vlerësimin e njohurive të arritura të nxënësve për këtë Gjysmëvjetor të vitit shkollor 2023-2024, ndërkaq nota mesatare e nxënësve për dy shkollat e mesme del 3.08 dhe atë në Gjimnazin "Skënderbeu" 3.64 dhe IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" 2.49.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr.6

Suksesi në shkollat e Mesme të Larta në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2023-2024

Emri i shkollës	Kasa	Të regjistruar						Vijojnë						SUKSESI POZITIV												SUKSESI NEGATIV						TË PA NOTUAR					
		Të regjistruar		Mirë		Sh.këllq.		Sh.mirë		Mjaft.		Gjith pozitiv		Shkëlq.		Mirë		Sh.mirë		Mjaft.		Gjith pozitiv		1X1		1X2		Përsërisin me 3x1		Gjithsej negativ		Nuk vijojnë çregjistr		Të		në mesatare	
		Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F		
		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%			%
%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%		%			
"Skënderbeu"	X	173	115	171	114	40	31	58	39	25	14	0	0	123	84	71.93	21	14	10	6	17	10	48	30	2	1	0	0	0	0	0	0	3.69				
	XI	188	115	183	113	41	39	45	28	39	16	1	0	126	83	68.85	21	13	13	5	23	12	57	30	5	2	0	0	0	0	0	0	3.51				
	XII	199	133	198	132	65	54	43	34	27	18	1	0	136	106	68.69	25	19	11	5	26	2	62	26	1	1	0	0	0	0	0	0	3.72				
"F.G dhe y"	X-XII	560	363	552	359	146	124	146	101	91	48	2	0	385	273	69.75	67	46	34	16	66	24	167	86	8	4	0	0	0	0	0	0	3.64				
	X	161	27	135	24	1	0	13	2	32	9	6	1	52	12	38.23	22	5	14	3	47	4	83	12	1	0	25	3	0	0	0	0	2.59				
	XI	150	31	146	30	5	2	7	1	27	6	5	2	44	11	29.93	31	8	24	1	47	10	102	19	2	0	2	1	0	0	0	0	2.51				
IAAP "F.G dhe y"	XII	94	24	89	23	4	1	6	3	21	6	7	3	37	13	41.11	18	3	12	2	22	5	52	10	1	0	4	1	0	0	0	0	2.49				
	X-XII	405	82	370	77	10	3	26	6	80	21	18	6	133	36	35.94	71	16	50	6	116	19	237	41	4	0	31	5	0	0	0	0	2.53				
	Gjithsej	965	445	922	436	156	127	172	107	171	69	20	6	518	309	56	138	62	84	22	182	43	404	127	12	4	31	5	0	0	0	0	3.08				

9. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në AML

Nxënësit e këtij niveli, në fund të kësaj periudhe, kanë bërë gjithsej 29,919 mungesa (15,508 nxënësit e Gjinnazit dhe 14,411 ata të IAAP) prej të cilave me arsye 23,550 ose 32.45 për kokë nxënësi. Numri i orëve të humbura nga nxënësit dhe arsimtarët është relativisht i lartë, ndërkohë që DA kërkon nga shkollat përkatëse të ndërmarrin masat e duhura me qëllim të zvogëlimit në minimum numrin e orëve të humbura mësimore. Po ashtu, mësimdhënësit e nivelitë AML-së kanë humbur gjithsej 751 orë mësimi apo 8.63 orë mësimi për një mësimdhënësi.

Kualifikueshmëria dhe ngritja profesionale është kusht elementar dhe kyq për realizimin e suksesshëm të plan-programit mësimor dhe njëkohësisht është faktor për mësimdhënie e nxënie të suksesshme. Kështu, në fillim të vitit shkollor në dy shkollat e këtij niveli janë

angazhuar gjithsej 87 mësimdhënës, të gjithë të kualifikuar (100%), prej tyre 42 në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe 45 në IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, të cilët rezultojnë, po ashtu, të gjithë të kualifikuar (100%).

Për më shumë informata shih Tabelën Nr.7

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në shkollat e Mesme të Larta

Tab.Nr.7										
Nr.	Emri i shkollës	KUADRI ARSIMOR				Mungesat e nx		Mesatarja për nxënës	Orët e humbura të arsimtarëve	Mesatarja për arsimtarë
		Gj	F	KV	%	Gj	Arsyeshme			
1	Skënderbeu	42	22	42	100	15508	11248	27.69	470	11.19
2	IAAP	45	15	45	100	14411	12302	38.63	281	5.5
	Gjithsej	87	37	87	100	29919	23550	32.45	751	8.63



Drejtori i Drejtorisë
 Fabir Doda